



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 22
Prishtinë, më 10.10.2012, në orën 13.00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Biserka Kostiq, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Kimete Bytyçi dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Duda Balje, Justina Pula dhe Albana Gashi,

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Pjesëmarrës të tjerë: Nevahir Hazeri-KDI; Reshit Gashi-NDI; Visar Bivolaku-Eu OFFICE-EUSR; Florie Kryeziu dhe Burim Tahiri –UNICEF; Elita Vokshi dhe Floriana Shala-OSBE; Afrim Maliqi dhe Osman Shatri-HANDIKOS; Jan Pekins dhe Shpend Qamili-OSBE; Valentina Demolli-D4J dhe Ukë Gashi-ZPRK.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara;
3. Shqyrtimi i Draftudhëzuesit për shqyrtimin e peticioneve;
4. Shqyrtimi i peticioneve;
5. Takim i Komisionit me përfaqësuesit e HANDIKOS-it, lidhur me kërkesën për hartimin e Projektligjit për paraplegji dhe tetraplegji në Kosovë;
6. Të ndryshme.

Kryetarja- Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoi që pika e tretë e rendit të ditës të zëvendësohet me pikën e 5-të, për shkak që të mos u merret shumë kohë përfaqësuesve të HANDIKOS-it, ndërsa pika e tretë të shqyrtohet si pikë e pestë e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua me këto ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara

Kimete Bytyçi dhe Kymete Bajraktari patën vërejtje në procesverbalin e dt. 21 gusht, duke kërkuar që diskutimet e tyre të përfshihen në procesverbal, ndërsa Kimete Bytyçi pati vërejtje për arsye se pyetjet e saj nuk ishin të përfshira në procesverbal, që kanë të bëjnë me kërkesat banorëve të lokalitetit të Orllanit, lidhur me ujësjellësin dhe kanalizimin.

Komisioni, me vërejtjet e bëra, e miratoi procesverbalin e datës 21. 08. 2012, ndërsa procesverbalet e datës 22 gusht dhe 4 shtator u miratuan pa vërejtje.

3. Takim i Komisionit me përfaqësuesit e HANDIKOS-it, lidhur me kërkesën për hartimin e Projektligjit për paraplegji dhe tetraplegji në Kosovë

Suzan Novoberdaliu – Pasi përshëndeti të pranishmit, si dhe përfaqësuesit e organizatës së HANDIKOS-it, njoftoi Komisionin lidhur me kërkesën e kësaj organizate për hartimin e Projektligjit për paraplegji dhe tetraplegji në Kosovë. Ajo e ftoi përfaqësuesin e HANDIKOS-it, z. Afrim Maliqin që ta marrë fjalën dhe në pika të shkurtra të njoftojë Komisionin me kërkesën për nismat legjislative, si dhe me nevojat që ballafaqohet kjo organizatë.

Afrim Maliqi, drejtor i HANDIKOS-it – Përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe kërkoi që të iniciojë plotësim-ndryshimin ose hartimin e një ligji të ri për këtë kategori. Ai i njoftoi anëtarët e Komisionit se prej 18 mijë personave me aftësi të kufizuar sa ka në Kosovë, 560 prej tyre janë paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Nevojat mujore të kësaj kategorie, tha në vijim Maliqi, janë më shumë se 250 euro në muaj, ndërkaq sipas ligjit në fuqi, ata realizojnë të ardhura mujore në shumën prej 45 euro. Për më shumë, Maliqi po ashtu njoftoi se vetëm në dy vitet e fundit, si pasojë e kujdesit të pamjaftueshëm, kanë vdekur dhjetë persona të kësaj kategorie.

Rita Hajzeraj – Tha se është dakord që të merret iniciativa për hartimin e ligjit për këtë kategori të personave nevojtarë, ndoshta do të duhej të kishte edhe debat më të gjerë për këtë, por unë jam dakord që t'ju ndihmohet në çdo aspekt.

Kimete Bytyçi – Duke u ndërlidhur me fjalën e përfaqësuesit të HANDIKOS-it, ajo tha se u përmend një moshë shumë e re, ku u tha se janë diku 10 persona që kanë vdekur, po më intereson se kjo a është e shprehur më shumë tek foshnjat, apo tek personat pak më të

rritur, moshat 15 apo 16 vjet, sepse ka raste që foshnjat lindin me këtë problem, pra mua më intereson se cila moshë është më shumë e prekur.

Afrim Maliqi- Kur e kam përmendur moshën e re, nuk kam menduar për fëmijë, sepse lëndime të boshtit kurrizor më shumë pësojnë të rriturit, mosha prej 20 deri 35 vjeçare apo 40, por ka të prekur edhe në moshën më të re.

Kurtan Kajtazi –Si Komision dhe si institucione kemi për obligim të shtyjme përpara procesin për miratimin e një projektligji në Kuvendin e Kosovës, edhe pse nuk ka mundësi buxhetore që në vitin e parë të përfitojnë benificione të tjera personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Më intereson se kjo organizatë a e ka përkrahjen e të gjithë personave të kësaj kategorie dhe a janë të mbledhura të gjitha shoqatat rreth HANDIKOS-it, sepse ka edhe tjera OJQ dhe nuk po krijojnë pajtueshmëri në mes veti për shumë çështje.

Shumë shpejt do ta iniciojmë këtë çështje edhe me ministrin e MPMS-së dhe do të fillojmë përgatitjen për hartimin e një ligji.

Ai gjithashtu bëri pyetje se sa është numri i përfituesve të benificioneve të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë në Kosovë.

Afrim Maliqi – Këtë numër nuk e di saktësisht.

Ai tha se nga shteti nuk marrë asnjë cent, përkundrazi tha se kontribuoj për shtetin, paguaj tatime, bëj projekte. Organizata HANDIKOS ka 94 punëtorë, ndërsa që të gjithë jemi tatimpagues, kemi bërë shpërndarje të karrocave.

Suzan Novoberdaliu – Tha se i jap mbështetje kësaj kategorie të shoqërisë dhe propozoi që Komisioni t'i drejtohet me një kërkesë, Zyrës për Qeverisje të Mirë për hartimin e Projektligjit për paraplegji dhe tetraplegji.

Ajo gjithashtu kërkoi që të ftohen ministrinë përkatëse dhe të shikohet se a janë nxjerrë aktet nënligjore në afatin e caktuar, që kanë të bëjnë me këtë kategori të shoqërisë. Nëse nuk janë nxjerrë, pse nuk është respektuar ligji që ka të bëjë me këtë kategori?

Pas një debati të gjerë dhe konstruktiv, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Komisioni do të kërkojë nga ministrinë përkatëse nxjerrjen e akteve nënligjore që mbulojnë të drejtat e kësaj kategorie, si dhe do të kërkojë informatë me shkrim nga këto ministri.

Gjithashtu, kërkohet nga Zyra për Qeverisje të Mirë, që të merret nisma për hartimin e Projektligjit për paraplegji dhe tetraplegji.

4. Shqyrtimi i peticioneve

Kurtan Kajtazi – Në cilësi të raportuesit, tha se i kemi për shqyrtim dy peticione. Njëri petition është i ngritur nga A.M. nga Gjilani, i cili ankohet se i është ngritur qiraja dhe nuk mund ta paguajë, duke theksuar se kjo zeje nuk sjell tani fitime të mëdha.

Kërkesa e dytë ka të bëjë me Q.S. nga Komuna e Kamenicës, që ka të bëjë me tokën e cila tani është në kuadër të Komunës së Ranillugut. Ai u kërkon organeve komunale për ndërrimin e një objekti, për të cilin Komuna e Ranillugut nuk i ka dhënë leje urbanistike. Komisioni, pas një debati të gjerë dhe konstruktiv lidhur me këto dy shqetësime të qytetarëve, nxori këtë

Përfundim

Komisioni vendosi që lidhur me këto çështje të realizojë një vizitë zyrtare në Komunën e Gjilanit dhe në atë të Ranillugut dhe pasi të informohet për së afërmi, do të nxjerrë përfundimet përkatëse. Data e vizitës në terren do të caktohet nga ana e kryetares së Komisionit.

5. Shqyrtimi i Draftudhëzuesit për shqyrtimin e peticioneve

Suzan Novoberdaliu – Në pika të shkurtra i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me punën që është bërë në Draftudhëzuesin për shqyrtimin e peticioneve dhe ftoi që ta marrë fjalën.

Reshit Gashi – Lidhur me Draftudhëzuesin për shqyrtimin e peticioneve, theksoi se për dallim nga drafti i parë, janë bërë disa ndryshime në rregullën e 12-të, për shkak se nga janari 2013, çështjet administrative do të kalojnë në kompetencë të gjykatave.

Ai tha se Draftudhëzuesi për shqyrtimin e peticioneve ka një rendësi të veçantë, sepse i ndihmon Komisionit në dallimin e peticioneve publike dhe atyre private.

Pra, peticionet me rendësi të përgjithshme publike, janë peticionet e ambientit, të arsimit shëndetësisë, ndërsa gjatë shqyrtimit të tyre duhet një procedurë hulumtuese deri në fund, duke njoftuar Kuvendin me rekomandimet e nxjerra nga ana e Komisionit, të cilat Kuvendi ia procedon Qeverisë së Kosovës.

Biserka Kostiq – Duke u ndërlidhur me çështjen e peticioneve, tha se mua më intereson se kush i përkthen peticionet në gjuhën time amtare. Kemi një lëshim, sepse këtu nuk dihet se kush duhet ta përkthejë peticionin në gjuhën time amtare dhe më intereson se a e keni paraparë këtë.

Reshit Gashi – Kam thënë se për të qenë peticioni i pranueshëm, duhet të jetë i paraqitur në njërën nga gjuhët zyrtare, ndërsa për të siguruar funksionimin e dygjuhësisë është shërbimi i përkthimit këtu në Kuvend.

Biserka Kostiq – Jeni të obliguar të më siguron përkthimin gojarisht dhe të njoftohem me peticionin. Detyra juaj është t' ma dërgoni materialin në gjuhën time amtare tri ditë para mbledhjes së Komisionit, sepse unë mund të shtyj pikën e rendit të ditës për një ditë tjetër, nëse nuk e kam të siguruar materialin në gjuhën time.

Peticioni adresohet në Komision, ndërsa Komisioni duhet ta ketë peticionin, unë jam pjesë e këtij Komisioni dhe duhet ta kem, në mënyrë që të di se çka po ndodh në Komision.

Rita Hajzeraj- Është mirë që ne si Komision, të mbajmë një mbledhje ekskluzivisht veç për këtë draft dhe ta analizojmë rresht për rresht, ndërsa kush ka diçka, le t'i parashtrojë. Unë propozoj që sot në parim ta miratojmë këtë udhëzues dhe në të ardhmen të analizojmë mirë se çka mund të ndryshojmë.

Kryetarja- Pajtohem me propozimin e Ritës. Edhe unë kam disa vërejtje qysh në fillim. Tani po e miratojmë në parim, kam një formular të Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili është shumë i thjeshtë dhe i qartë. Ne duhet t' i thjeshtësojmë procedurat, që të jetë diçka më e lehtë edhe për qytetarin, edhe për ne që po punojmë.

Kurtan Kajtazi – E kam lexuar këtë draft, është i mirë. Jemi Komision i Kuvendit të Kosovës dhe peticionet duhet t'i shqyrtojmë qartë dhe mirë. Me këtë rregullore na lehtësohet shumë puna, pavarësisht asaj se a kemi vështirësi në punë, derisa të miratohet kjo rregullore. Mendoj se për gjeneratën e ardhshme dhe deputetët e ardhshëm, do të jetë shumë më lehtë për t'i shqyrtuar peticionet. Gjithashtu, kemi marrë një qëndrim që të njoftojmë Kryesinë e Kuvendit se është duke u bërë një doracak për shqyrtimin e peticioneve.

Biserka Kostiq – Në diskutimin e saj theksoi se nuk është kundër Rregullores, as peticioneve, por që nga fillimi ka probleme, për shkak të pamundësisë që materialet t'i ketë në gjuhën amtare.

“Unë jam e informuar se këto janë probleme të administratës, por unë dëshiroj që kjo çështje të rregullohet dhe të dihet se në kompetencën e kujt janë peticionet”- tha ajo.

Gjithashtu, ajo tha se më intereson të di se kush duhet t'i përkthejë peticionet dhe kërkoi që ky problem sa më shpejt të zgjidhet.

Rita Hajzeraj- Duke u ndërlidhur me parafolësen, tha se nëse edhe mua më vjen një material vetëm në gjuhën serbe me përmbajtje prej 50 faqeve, edhe unë do të kërkoja që ai material të më përkthehet në gjuhën shqipe, ndoshta nuk mund të përkthehet faqe për faqe, por përmbajtjen e saj gjithsesi dhe kjo duhet të ekzistojë reciprokisht.

Pas një diskutimi të gjerë që u zhvillua nga ana e anëtarëve të Komisionit, lidhur me punën që është bërë rreth Draftudhëzuesit për shqyrtimin e peticioneve, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Komisioni unanimisht vendosi që ta votojë në parim Draftudhëzuesin për shqyrtimin e peticioneve dhe u dakordua që në fillim të muajit nëntor, të organizojë një tryezë jashtë hapësirave të Kuvendit, në të cilën do të shqyrtohet, analizohet në mënyrë të detajuar dhe secili anëtar i Komisionit të japë mendimin e vet.

NDI-ja do të mbështesë Komisionin rreth organizimit të kësaj tryeze.

6. Të ndryshme

Kryetarja – Tha se prezent janë përfaqësuesit e OSBE-së, të cilët do të organizojnë një trajnim për mbikëqyrjen financiare të institucioneve, fjalën ua dha përfaqësuesve të OSBE-së.

Jan Pekins, OSBE – Foli për hapat që janë ndërmarrë rreth bashkëpunimit me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe dokumentet që ata kanë ofruar.

Ky projekt ka për qëllim trajnimin e anëtarëve të Komisionit për mënyrat dhe procedurat e mbikëqyrjes së parasë publike të institucioneve dhe agjencive financiare.

Komisioni vendosi, që në një afat sa më të shpejt, të mbahet një dëgjim publik.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu